33.2 Kontraktuesi mund të aplikojë, duke njoftuar Autoritetin Kontraktues, për një certifikatë të pranimit të përkohshëm jo më herët se 15 ditë para se punët, sipas mendimit të Kontraktuesit, të jene të gatshme për pranim të përkohshëm. Autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh pas pranimit të aplikacionit të Kontraktuesit ose:

- a) t'i lëshojë kontraktuesit certifikatën e pranimit të përkohshëm me një kopje për Autoritetin kontraktues duke thënë, nëse kjo është e përshtatshme, rezervat e tij, dhe përveç tjerash, edhe datën në të cilën sipas mendimit të tij janë përfunduar punët në pajtim me kontratën dhe janë të gatshme për pranim të përkohshëm; ose
- b) të refuzojë aplikacionin, duke i dhënë arsyet e tij dhe duke specifikuar veprimin të cilin, sipas mendimit të tij i kërkon nga Kontraktuesi për ta lëshuar certifikatën.

33.3 Nëse autoriteti kontraktues nuk arrin ose të lëshojë certifikatën e pranimit të përkohshëm ose të refuzojë furnizimet brenda një periudhe prej 30 ditësh, ai do të konsiderohet se ka lëshuar certifikatën në ditën e fundit të asaj periudhe.

33.4 Pas pranimit të përkohshëm të punëve, Kontraktuesi i çmonton dhe i heq strukturat e përkohshme dhe materialet që nuk kërkohen më për përdorim përkitazi me realizimin e kontratës. Ai gjithashtu do të heqë ndonjë mbeturinë apo pengesë dhe do të bëjë ndonjë ndryshim të gjendjes së vendit të pranimit siç kërkohen në kontratë.

Neni 34 Përgjegjësia mbi Defektet

34.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për mënjanimin e defekteve, ose dëmeve, në ndonjë pjesë të punëve të cilat mund të shfaqen apo shfaqen gjatë periudhës së defekteve dhe të cilat lindin nga ose:

- a) përdorimin i impiantit ose materialeve të dëmtuara ose mjeshtëria ose dizajni i gabueshme i Kontraktuesit; dhe / ose
- b) çdo veprim apo mosveprim i Kontraktuesit gjatë periudhës së defekteve.

34.2 Kontraktuesi me shpenzime të veta do ta përmirësojë defektin ose dëmin sa më shpejt të jetë e mundur. Periudha mbi përgjegjësinë e defekteve për të gjitha zëvendësimet ose rinovimet do të fillojë nga data kur zëvendësimi ose rinovimi është bërë për kënaqësinë e mbikëqyrësit. Nëse kontrata mundëson pranim të pjesshëm, periudha e defekteve do të vazhdojë vetëm për atë pjesë të punimeve e cila është ndikuar nga ndërimi apo rinovim.

34.3 Nëse shfaqet ndonjë defekt ose ndodh ndonjë dëm gjatë periudhës së përmendur, autoriteti kontraktues ose menaxheri i projektit do ta njoftojë Kontraktuesin. Nëse Kontraktuesi nuk arrin të korrigjojë një defekt ose një dëm brenda afatit kohor të përcaktuar në njoftim, autoriteti kontraktues mund të:

- a) të kryejë vetë punë, ose të punësojë dikë tjetër për kryerjen e punimeve, në rrezik dhe kosto të Kontraktuesit, në të cilin rast kostoja e shkaktuar nga autoriteti kontraktues do të zbritet nga pagesat e pritura ose nga garancitë që mbahen ndaj Kontraktuesit ose nga të dy; ose
- b) të ndërpresë kontratën.

34.4 Në raste urgjente, kur kontraktuesi nuk mund të arrihet menjëherë ose, pasi është arritur, nuk është në gjendje që të marrë masat e nevojshme, autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit mund të kryejnë punën në kurriz të Kontraktuesit. Autoriteti kontraktues ose Menaxheri i projektit duhet të informojë sa më shpejt që të jetë e mundur Kontraktuesin për veprimin e marrë.

34.5 Periudha e përgjegjësisë së defekteve do të parashihet në KVK dhe specifikimet teknike. Nëse kohëzgjatja e periudhës së përgjegjësisë së defekteve nuk është e specifikuar, ajo do të jetë 365 ditë. Periudha e Përgjegjësisë së defekteve do të fillojë në datën e pranimit të përkohshëm.

Neni 35 Pranimi përfundimtar

35.1 Pas skadimit të periudhës së garancisë ose, në rastet kur ka më tepër se një periudhë, pas skadimit të periudhës së fundit, dhe atëherë kur të jenë zgjidhur të gjitha defektet apo dëmet, autoriteti kontraktues do t'i lëshojë Kontraktuesit një certifikatë të pranimit përfundimtar, me një kopje Autoritetit kontraktues, duke cekur datën në të cilën Kontraktuesi i ka plotësuar obligimet e tij sipas kontratës dhe në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktues të jetë i kënaqur. Certifikata përfundimtare e pranimit do të lëshohet nga autoriteti kontraktues brenda 30 ditësh nga skadimi i periudhës së garancisë ose menjëherë pasi riparimet eventuale që janë kërkuar sipas Nenit 34 të jenë përfunduar në mënyrë të tillë që të jetë i kënaqur autoriteti kontraktues.

35.2 Punët nuk do të konsiderohen se janë realizuar plotësisht derisa të jetë nënshkruar certifikata përfundimtare e pranimit nga Menaxheri i Projektet dhe të jete dorëzuar tek autoriteti kontraktues, e një kopje tek Kontraktuesi.

35.3 Pa marrë parasysh lëshimin e certifikatës përfundimtare, Kontraktuesi dhe autoriteti kontraktues do të mbeten të detyruar për plotësimin e obligimeve që dalin sipas kontratës para lëshimit të certifikatës përfundimtare të pranimit dhe të cilat kanë mbetur të porealizuara në kohën kur lëshohet certifikata përfundimtare e pranimit. Natyra dhe masa e obligimeve të tilla do të përcaktohen duke iu referuar dispozitave të kontratës.

Shkelja e kontratës dhe shkëputja

Neni 36 Shkelja e kontratës

36.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë.

36.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/ose
- b) ndërprerjen e kontratës.

36.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpërblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

36.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhet Kontraktuesit, nga depozita, ose me pagesë nga siguria

Neni 37 Shkëputja e kontratës

37.1 Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi mund të shkëpus Kontratën në qoftë se pala tjetër shkakton një shkelje themelore të Kontratës.

37.2 Shkelja themelore e kontratës do të përfshijnë, por nuk do të kufizohet në:

- a. Kontraktuesi ndërpre punën për 15 ditë rresht pa qenë e përfshirë kjo ndërprerje në programin e punës si dhe pa autorizim të menaxherit të projektit;
- b. Menaxheri i projektit urdhëron Kontraktuesin pa arsye të justifikuar të ndërpresë apo pezullojë aktivitetin e punëve të kontraktuara për më shumë se 15 ditë pune; ose marrëveshjet e arritura mbi pagesat për shkak të kontraktuesit për kosto të vonësës;
- c. Autoriteti Kontraktues ose Kontraktuesi falimenton apo hyn në likuidim tjetër nga rindërtimi ose shkrirja;
- d. Pagesa e vërtetuar nga Menaxheri i Projektit, nuk paguhet nga Autoriteti Kontraktues brenda 30 ditësh nga data e certifikatës së Menaxherit të Projektit;
- e. Menaxheri i Projektit njofton se mos korrigjimi i defekteve është shkelje e kontratës dhe Kontraktuesi nuk arrin t'i korrigjoj brenda 30 ditëve të përcaktuara nga ana e Menaxherit të Projektit;
- f. Kontraktuesi vonohet në përmbushjen e kontratës për numrin e ditëve për të cilat shuma minimale e dëmeve të likuiduara mund të paguhet.

37.3 Kur pala tjetër kontraktuese bën shkelje të kontratës për raste të tjera nga ato të parapara me Nenin 37.2, Menaxheri i Projektit do të vlerësojë nëse shkelja materiale e kontratës paraqet bazë për shkëputje të kontratës.

37.4 Nëse për shkak të fajit të palës së tretë krijohen rrethana emergjente objektive dhe kjo e pengon përmbushjen e detyrimeve të kontratës, Menaxheri i Projektit me pëlqimin e Kontraktuesi do të përfundoj vazhdimësinë e përmbushjes së punëve sa më parë që është e mundur. Menaxheri i Projektit do të bëjë vlerësimin e punës së kryer pjesërisht, do të kërkojë nga kontraktuesi të largohet nga zona e punës dhe ta lënë atë në një gjendje të mirë. Menaxheri i Projektit duhet të paguajë kontraktuesin për punët e kryera deri në momentin e marrjes së njoftimit me shkrim për ndërprerje.

37.5 Në qoftë se kontrata shkëputet, Kontraktuesi do të ndërpres punën menjëherë, do të siguroj vend punimin dhe ta liroj vend punimin brenda 15 ditëve nga përfundimi i periudhës së njoftimit.

Neni 38 Forca madhore

38.1 "Force Madhore" siç përdoret këtu mendohet në çrregullimet industriale, çrregullimet civile, luftërat, eksplozimet, tërmeti, zjarret, vërshimet, epidemitë etj e shkaktuar jo me fajin apo neglizhimin e palëve kontraktuese, e paparashikueshme dhe jashtë kontrollit të palëve kontraktuese.

38.2 Në rast se ndodh ndonjëra nga ngjarjet që përcakton Forcën Madhore dhe kjo i bën të pamundur punëmarrësit kryerjen e obligimeve dhe përgjegjësi të parapara me kontratë, punëmarrësi sa më shpejtë që është e mundur duhet t'i sigurojë punëdhënësit një deklaratë me shkrim me të dhënat e plota lidhur me ngjarjen. Në këtë rast aplikohen dispozitat si në vijim:

- i. Obligimet dhe përgjegjësitë e kontraktuesit do të pezullohen deri sa të arrihet niveli i mundësisë objektive së përmbushjes së tyre.
- ii. Gjatë pezullimit dhe në lidhje me punët e pezulluara, të gjitha shpenzimet lidhur me riparimin e pajisjeve teknike, akomodimit të personelit dhe shpenzimet tjera të ngjashme i bart kontraktuesi.
- iii. Brenda pesëmbëdhjetë 15 ditë, duke llogaritur nga dita e ngjarjes që përcakton Forcën Madhore, Menaxheri i Projektit në bashkëpunim me Autoritetin Kontraktues duhet t'i vlerësojë të gjitha punët e përfunduara në mënyrë që Autoriteti Kontraktues ta paguajë kontraktuesin.
- iv. Afati për përmbushje të obligimeve nga Kontraktuesi të detyrimeve të kontratës mund të zgjatet edhe për një periudhë për aq sa ka zgjatur periudha e pezullimit.
- v. Në qoftë se kontraktuesi për një kohë të gjatë është bërë i pa aftë, për shkak të Forcës Madhore, për t'i kryer obligimet dhe përgjegjësitë e parapara me kontratë, Autoriteti Kontraktues brenda shtatë 7 ditë mund ta njoftojë me shkrim kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës.

Neni 39 Pagesa pas shkëputjes së kontratës

39.1 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të shkeljes materiale të kontratës nga ana e kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të përpilojë shkresën mbi vlerësimin e punës së përfunduar dhe materialet e porositura duke i llogaritur ato me minus pagesat në avans që janë marrë para datës së lëshimit të shkresës në fjalë dhe minus përqindjen e vlerësuar të punëve të pakryera, siç është cekur në KVK. Dëmet shtesë të likuidimit nuk do të aplikohen. Nëse shuma totale e borxhit të Autoritetit Kontraktues tejkalon ndonjë pagesë si borxh ndaj kontraktuesit, diferenca do të jetë obligim borxhi ndaj Autoritetit Kontraktues.

39.2 Nëse kontrata ndërpritet për shkak të interesit të Autoritetit Kontraktues ose shkeljes materiale bazë të kontratës nga Autoriteti Kontraktues, Menaxheri i Projektit do të lëshoj një certifikatë për vlerën e punës së bërë, materialet e porositura, koston e arsyeshme të heqjes së Pajisjeve, riadhesimit e personelit të Kontraktuesit i punësuar vetëm për Punët, shpenzimet e Kontraktuesit për mbrojtjen dhe sigurimin e Punëve dhe pagesat në avans të marra deri në datën e certifikatës.

Neni 40 Prona

40.1 Të gjitha materialet dhe pajisjet e ndërtimit në vend punim, Impiantet, Punët e Përkohshme, dhe Punët do të konsiderohen të jenë pronë e Autoritetit Kontraktues nëse Kontrata ndërpritet për shkak të gabimit të Kontraktuesit.

Neni 41 Lirimi nga Ekzekutimi

41.1 Në qoftë se pamundësohet përmbushja e kontratës nga shpërthimi i luftës apo ndonjë rasti tjetër jashtë kontrollit të Autoritetit Kontraktues ose Kontraktuesit, Menaxheri i Projektit do të vërtetoj këtë. Kontraktuesi do të siguroj vend punimin dhe do të ndërpres

punën sa më shpejt që është e mundur pas pranimit të këtij vërtetimi dhe do të paguhet për punët e kryera para pranimit të tij dhe për punët e kryera më pas për të cilat është arritur marrëveshje.

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Neni 42 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

42.1 Palët do t'i bëjnë të gjitha përpjekjet për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, Palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për pozitën e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado Palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgjigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse Pala dështon të përgjigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

42.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpiqen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do të ketë të drejtë të vazhdojë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 43 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

43.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) ose vendim nga gjyqi;
- b) kurdo qe palët pajtohen vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

43.2 Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

PJESA III E KONTRATES

kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënime kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante.]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë [SHQIPE].
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës në afat prej 270 ditësh
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	<p>Shuma minimale e sigurimit do të jetë:</p> <p>(a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë;</p> <p>(b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i Pajisjeve një shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre;</p> <p>(c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim i pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar.</p> <p>(d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje:</p> <p>(i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar</p> <p>e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhive është i pakufizuar</p>
Programi	12.1	Kontraktuesi do ta dorëzoj për aprovim Programin për Punët brenda 5 ditëve nga data e Nënshkrimit të kontratës..



	12.2	Periudha për Programin e azhurnuar është 15 ditë kalendarike nga data e pranimin të kërkesës së Menaxherit të projektit.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 15 dite pas nënshkrimit të kontratës.
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë 240 DITE
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë: 0.25% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë.
Regjistri i punës	20.1	Një regjistër i punës do të mbahen në vend-punishte nga ana e Kontraktuesit,
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit do të përcaktohet pas nënshkrimit të kontratës me vendim nga ZKA
Pagesa	24	Autoriteti Kontraktues do të paguaj kontraktuesit vlerën e kontraktuar në situacione jo me pak se 50000 euro, për punët e kryera dhe të konstatuara nga menaxheri i kontratës. Situacioni i fundit duhet të jete jo me pak 10% e vleres se kontrates me konstatim nga menagjeri i kontrates.
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është: nuk ka pagese paraprake
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është: 10% i vlerës se kontratës. Kjo shume do të ndalet nga çdo pagesë e Kontraktuesit dhe do të paguhet brenda 30 ditësh nga dita e lëshimit të deklaratës së llogarisë përfundimtare të referuar në Nenin 29 të KPK. Kontraktuesi mund të zëvendësoj paratë e mbajtura me garancion bankar “me kërkesë”. Shuma e parave të mbajtura do të mbahet gjate tere periudhës se defekteve: ■
Shkaqet për kompensim	30.1	Sipas Kushteve të pergjithshme
Përgjegjësia mbi Defektet	34.5	Periudha garantuese e defekteve është 5 VITE
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve të likuiduara.

Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni për Ndërmjetësim në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	<p>a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.</p> <p>ose</p> <p>b) kurdo që palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të Tribunali i Përhershëm i Arbitrazhit të Kosovës në kuadër të Odës Ekonomike të Kosovës, në përputhje me rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë.</p> <p>Para nënshkrimit të kontratës palët duhet të vendosin për mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes, gjykata apo arbit</p>

ÇMİMİ I TENDERİT

PARAMASA DHE PARALLOGARIA


Pos	Pershkrimi i pozicionit	Gjithsej
1	PUNET PERGATITORE	5,990.00
2	PUNET E GERMIMEVE , TRANSPORTIT DHE TE NGJASHME	146,945.00
3	PUNET NDERITIMORE	855,409.00
4	PUNET E PLANIFIKIMIT ANESOR	169,141.20
5	PUNET E INSTALIMEVE HIDROTEKNIKE - UJESJELLESI	134,013.00
6	PUNET E INSTALIMEVE HIDROTEKNIKE - KANALIZIMI FEKAL DHE ATMOSFERIK	232,717.50
7	PUNET E INSTALIMEVE ENERGETIKE DHE NDRIQIMIT	170,680.00
8	PUNET E SHENJEZIMIT HORIZONTAL DHE VERTIKAL	29,188.00
TOTALI		1,744,083.70



PARAMASA DHE PARALLOGARIA

1.1 Pos	Punet e Perqatjtes se punishtes	Pershkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Gjimi	Gjithsej
1.1.1	Mobilizimi i ndermarrjes per fillimin e punimeve ne projekt ndertimi i punishtes qe perfishine:		paushall	paushall	500.00	
1.1.2	a) Zyra e perkohshme e ndermarrjes me se paku 2 ndarje, secila ndarje duhet te kete se paku siperfaqe S=12m ² , me nje sanitare si dhe e kycur ne furnizimin me energji te pandrprere elektrike dhe te ujit. Zyra duhet te kete lidhje ne kanalizimin publik funksional ose ne nje rezervuar ekologjik mobil b) Zyra per organin mbikqyres (minimum S=16m ²), nje tavoline pune me minimum 6 karriga pune per gjate gjithë kohes se ndertimit c) eC ekologjike mobile per stafin punues eksekutiv per gjate gjithë kohes se ndertimit d) Furnizimi i zyrës me lidhje per komunikim: telefon, faks dhe internet per gjate gjithë kohes se ndertimit		p.s	1	1,000.00	1,000.00
1.1.3	Kontrollimi dhe evidentimi i instalimeve nentoksores, zgjidhja e problemeve eventuale qe lidhen me planin operativ te ndertimit si dhe perplimi i planit detal operativ qe lidhet me procesin e ndertimit. Ne çmim te logaritit edhe kosto eventuale e furnizimit te banoreve te prekur nga ndertimi me te gjitha shërbimet publike: uje sanitar, rryme elektrike, largim te ujtrave fekale si dhe me telefonin shërbime, Per te gjitha keto shërbime, kontaktori duhet te ofroj plan detal te furnizimit te perkohshem te banoreve dhe per te gjitha hargjimet mban pergjegjisin kontraktuse, dmth. investori nuk merr mbi vete kosto shitesse perveq çmimit qe kontraktori oferton ne kete pozicion, investitori ka te drejten e ndermarrjes se hapave qe te furnizoi vet banoret permes kontraktimit te nje kontraktori tjetër, permes nje kontrate emergjente (nje person tjetër juridik) dhe tere koston do ta mbaj kontraktori i kesij pozicioni		m'	830	1.00	830.00
1.1.4	Fiksimi i pikave kontrolluese gjeodezike si dhe sigurimi fizik i reperve te rrjetes shtetërore .Ne çmim te kalkulohet trasimi gjeodezik I vijave ku do te kaloj rrjeti hidroteknik .ujeshtellesi,kanalizimi fekal dhe kanalizimi atmosferik		m'	830	1.00	830.00
1.1.5	Sigurimi i punishtes nga nje institut i sigurimeve, te licensuar per kete veprimtari. Kjo polise sigurimi duhet te perfishije: a) Sigurimi i tere stafit punues per kohezgjatjen e punimeve. Ne polise duhet te jene te shenuar emrat dhe mblenrat e punetoreve si dhe vlera siguruese per cdo lloj fatkeqesie eventuale qe mund te kete pasoja shendetesore b) Sigurimi i zyreve ne rast fatkeqesie natyrore dhe nga nderhyrjet njeretore c) Sigurimi i demtimeve ndaj pales se tere		p.s	1	1,000.00	1,000.00
1.1.6	Shenjestrimi i instalimeve nentoksores te cilat nuk qvendesin nga pozicioni ekzistues. Te behet edhe shenjestrimi i lokacionit para fillimit te punimeve ku parashihet lokacioni per ndertimin e nenkallimeve ne vendet e caktuara nga projekti ideor.		p.s	1	1,000.00	1,000.00
1.1.7	Sigurimi i punishtes nga hyrjet anesore te automjeteve. Sigurimi te behet permes shenjave perkatese te cilat krijojn siguri dhe zhvillim normal te punimeve ne gjithe orarin sipas kerkesave te investitorit.		m'	830	1.00	830.00
1.1.8	Egzaminimi i materialeve dhe bazes se rruges para dhe pas vuarjes ne veper te tyre si psh. Asfaltit , gurti dhe elementeve tjera per shqyrtim . Kontraktori eshte i obliguar qe te sjelle ateste paraprake dhe perardhjen e materialeve para fillimit te punimeve.		p.s,	1.00	500.00	500.00
Total Pozicioni 1.1 :					5,990.00	

Total Pozicioni 1.1 : 5,990.00



PARAMASA DHE PARALLOGARIA

2.1	Demolimi i instalimeve dhe objekteve	Perishkrimi i pozicionit	Njesia	Sasia	Cmimi	Gjithsej
2.1.1	Prejra dhe largimi i drunjeve, shkurrave dhe materialeve tjera te ciat jane ne luginen e perroit dhe siperfaqeve anesore te perroit dhe rruges per nderfim dhe bartja e tyre ne nje deponi ku e cakton organi pergjegjes i punishtes.		m ³	830.00	1.00	830.00
2.1.2	Demolimi i shtresave te asfaltit, pllakeve te trotuarit, gurave skajorw, ngarkimi dhe transporti deri ne 20km.		m ²	5900.00	1.00	5,900.00
2.1.3	Demolimi i shenjave vertikale te signalizimit, shenjat duhet te transportohen deri ne deponi ne komunw, largwsia 10km		copw	15.00	25.00	375.00
2.1.4	Germimi i siperfaqes se gjere te rruges sipas seksioneve ose profileve terthore dhe me nje gjeresi shtese ku parashihen muret mbrojtese ne dy anet e rruges e sidomos ne anen e majte. Germimet e dherave jane masive me permbajtje nga germimet dhe mbetjet urbane te qytetit. Germimet duhet te kryhen pjese pjese edhe ate ne gdo 100 m. Punimet duhet te permbahen udhezimeve nga projekti dhe organit mbikqyres.		m ³	44800.00	3.00	134,400.00
2.1.5	Mbushja e siperfaqeve anesore per planifikim e gjere te rruges ne dy anet sipas projektit. Mbushja duhet te behet me dhe humusor. Ne gretim duhet parashihet edhe mbjellja e barit ne tere hapesiren e parapare.		m ³	2720.00	2.00	5,440.00
Total Pozicioni 2.1 :						146,945.00

Total Pozicioni 2 : **146,945.00**



PARAMASA DHE PARALLOGARIA

3.1	Pos	Pershkrimi i pozitacionit	Mësi	Sasia	Cmimi	Gjithësi
3.1.1		Planifikimi paraprakë I tërë seksionit të trupit të rruges dhe nivelizimi sipërfaqësor për krijimin e kushteve paraprake për vendosjen e kalldermit sipas udhëzimeve në projekt. Punimet duhet të kryhen me maqina të përshtatshme të rrugëve.	m ²	30350.00	0.10	3,035.00
3.1.2		Furnizimi, transporti dhe shtrirja e shtresës së gjeotekstilit në pjesën e rruges. Gjeosintetika duhet të jetë 315 g/m ² dhe duhet të përmbushë të gjitha kërkesat teknike sipas normave dhe standardëve në fuqi për këtë lloj materiali.	m ²	30350.00	0.80	24,280.00
3.1.3		Furnizimi, transporti dhe shtrirja e reres për mbrojtjen e gjeotekstilit në pjesën e seksionit të rruges me trashësi min 5 cm duke parapare edhe nivelizimin për shtresat në vazhdim sipas profilat tërthor.	m ³	1520.00	4.00	6,080.00
3.1.4		Furnizimi me material për shtruarjen e kalldermit me gure gelqeror me permasa deri në 30 cm. Guret duhet të jenë në forma jo të rregullta dhe jopllakore. Shtruarja duhet të bëhet me dorë. Materiali pas shtrimit gjithmonë duhet të nënshtrohet ngjeshjes duke kontrolluar gjithmonë mundësinë e uljeve. Punimet duhet të përmbahen udhëzimeve nga projekti dhe nën përcjelljen e organit mbikqyres.	m ³	1890.00	30.00	56,700.00
3.1.5		Furnizimi me material për mbushjen e trupit të rruges - subbazës në kater shtresa. Materiali duhet të jetë nga shtresat e çakellit e prodhuar nga shkëmbi gelqeror dhe granulometri të kontrolluar. Punimi I këtyre shtresave duhet të punohet sipas udhëzimeve të veqanta nga projekti dhe organit mbikqyres.	m ³	15120.00	6.00	90,720.00
3.1.6		Furnizimi, transporti dhe shtrirja e shtresës së poshtme të zhavorit - agregatit (mbrojtja kundër ngricave), fraksion 0-64,0 mm në pjesën e seksionit të rruges me shtresa me trashësi d=30 cm, duke e përfshirë edhe ngjeshjen me cilindër vibrues 25t deri në masë densiteti të kërkuar sipas normave dhe standardëve në fuqi për këtë lloj pune (M _t ≥1200 kg/cm ²).	m ³	13095.00	8.00	104,760.00
3.1.7		Furnizimi, transporti dhe shtrirja e shtresës së poshtme - fraksion 0-30 mm në pjesën e trupit të rruges me trashësi të shtresës d=20 cm, duke e përfshirë edhe ngjeshjen me cilindër vibrues 25t deri në masë densiteti të kërkuar sipas normave dhe standardëve në fuqi për këtë lloj pune (M _t ≥1200 kg/cm ²).	m ³	5500.00	8.00	44,000.00
3.1.8		Furnizimi, transporti dhe shtrirja e shtresës së poshtme - fraksion 0-30 mm në pjesën e trotuareve dhe shtegut për biçiklist me trashësi të shtresës d=30 cm, duke e përfshirë edhe ngjeshjen në shtresa me cilindër sipas normave dhe standardëve në fuqi për këtë lloj pune.	m ³	1645.00	8.00	13,160.00
3.1.9		Furnizimi, transporti dhe vendosja e shtresës mbajtëse (tamponi) nga bitozhavori në trupin e rruges me trashësi të shtresës d=12 cm, duke e përfshirë edhe ngjeshjen me cilindër vibrues 25t deri në masë densiteti dhe trafshimi të kërkuar sipas normave dhe standardëve në fuqi për këtë lloj pune.	m ²	16835.00	10.00	168,350.00
3.1.10		Furnizimi, transporti dhe shtrirja e shtresës lidhëse në trupin e rruges me trashësi të shtresës d=6 cm si dhe përpunimi i shtresës sipas normave dhe standardëve në fuqi për këtë lloj pune.	m ²	16835.00	6.00	101,010.00



3.1.11	Furnizimi, transporti dhe shtrirja shtreses komunikuese nga asfaltbetoni ne tere siperfaqen e trupit te rruges me trashesi te shtreses d=4 cm si dhe perpunimi i shtreses sipas normave dhe standardeve ne fuqi per kete lloj pune. Receptura per kete shtrese duhet ti permbahet udhezimeve te projektantit dhe organit mbikqyres per shikake te llojit te qurrit i cili eksploatohet deri ne fabrik.	m ²	16835.00	4.00	67,340.00
3.1.12	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e shtreses korinikuese ne shiritin e veqant per biqiklist me trashesi te shtreses d=6 cm si dhe perpunimi i shtreses sipas normave dhe standardeve ne fuqi per kete lloj pune.	m ²	1520.00	6.00	9,120.00
3.1.13	Furnizimi me material nga zhavori natyral ne dy skajet e rruges dhe mbrapa mureve mbrojtese per nderfimin e kanaleve te drenimit . Pozicionet e vendosjes se zhavorit te muret dhe kanalet te parashihen sipas detajeve ne projekt.	m ³	768	6.00	4,608.00
3.1.14	Furnizimi me gyp nga materiali PVC , per vendosjen ne kanal in e drenimit dhe mbrapa mureve mbrojtese. Gypi duhet te jete i tipit te veqant per drenazh dhe me dimension D=250 mm.	m'	1600	4.00	6,400.00
3.1.15	Furnizimi, transporti dhe vendosja e gureve skajor nga betoni per kufizimin e trotuareve me dimensione 18x24cm sipas normave dhe standardeve ne fuqi per kete lloj pune.	m'	1810.00	9.00	16,290.00
3.1.16	Furnizimi, transporti dhe vendosja e gureve anesor nga betoni per mbeshtetjen e shiritit te mesit me dimensione 20x30 cm sipas normave dhe standardeve ne fuqi per kete lloj pune.	m'	1710.00	6.00	10,260.00
3.1.17	Furnizimi, transporti dhe vendosja e gureve skajor nga betoni per mbeshtetjen e kubezave te trotuarit me dimensione 10x20 cm sipas normave dhe standardeve ne fuqi per kete lloj pune.	m'	4450.00	6.00	26,700.00
3.1.18	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e shtreses perfundimtare per trotuar me kubeza me trashesi 6cm duke parapare edhe shtruarjen e shtreses se reres per nivelizim si dhe perpunimi dhe ngjeshja perfundimtare sipas normave dhe standardeve ne fuqi per kete lloj pune.	m ²	4525.00	12.00	54,300.00
3.1.19	Furnizimi, transporti dhe betonimi i themeleve dhe murit mbrojtës ne pjeset anesore sipas profileve te veqanta dhe lartësive te ndryshueshme nga betoni i armuar C 30/37.	m ³	250.00	70.00	17,500.00
3.1.20	Furnizimi, transporti dhe montimi i armatures se brinjzuar S-400/500 dhe armatures rrjet 500/560 per murin mbrojtës.	kg	18750.00	0.80	15,000.00
3.1.21	Furnizimi, transporti dhe betonimi i tobinave sipas detailt ne projekt nga betoni i armuar C 30/37.	m ³	110.00	70.00	7,700.00
3.1.22	Furnizimi, transporti dhe montimi i armatures se brinjzuar S-400/500 dhe armatures rrjet 500/560 per murin mbrojtës.	kg	10120.00	0.80	8,096.00
Total Pozicioni 3.1 :					855,409.00

Total Pozicioni 3 : **855,409.00**



PARAMASA DHE PARALLOGARIA

4.1. Pos	Pershkrimi i pozicionit	Mesia	Sasia	Grimi	Gjithsej
4.1.1	Planifikimi dhe nivelizimi i nenbazes ne pjesen e trotuareve anesore sipas profileve te veqanta edhe ate sipas planifikimit ne projekt si dhe ngjeshja e saj me cilindri deri ne mase te kerkuar sipas normave dhe standardeve per kete lloj pune (Mt >= 400 kg/cm ²).	m ²	5,853.00	0.40	2,341.20
4.1.2	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e shtreses se poshtme - fraksion 0-30 mm ne pjesen e trotuareve afer objekteve me trashesi te shtreses d=25 cm, duke e perfshire edhe ngjeshjen me cilindri sipas normave dhe standardeve ne fuqi per kete lloj pune.	m ³	1,465.00	8.00	11,720.00
4.1.3	Furnizimi, transporti dhe shtrirja e shtreses se poshtme - fraksion 0-30 mm per bazen e shkalleve ku ato planifikohen ne pjeset e hapësirës se shetitores me trashesi te shtreses d=20 cm, duke e perfshire edhe ngjeshjen me cilindri sipas normave dhe standardeve ne fuqi per kete lloj pune.	m ³	1,170.00	8.00	9,360.00
4.1.4	Furnizimi, transporti dhe vendosja e shtreses perfundimtare per trotuar me kubeza me trashesi 6cm duke parapare edhe shtruarjen e shtreses se reres per nivelizim si dhe perpunimi dhe ngjeshja perfundimtare sipas normave dhe standardeve ne fuqi per kete lloj pune. Modeli i kubzave duhet pershitur ne kerkesat ne projekt dhe udhezimeve nga organi mbikqyres.	m ²	5,853.00	10.00	58,530.00
4.1.5	Furnizimi, transporti dhe vendosja e rigolave me dimensione 15x22x100cm ne pjesen e trotuareve si dhe perpunimi sipas normave dhe standardeve ne fuqi per kete lloj pune.	m ¹	1,200.00	13.00	15,600.00
4.1.6	Furnizimi, transporti dhe vendosja e ujembledhsave ne pjesen anesore te trotuareve dhe shetitores si dhe nivelizimi i tyre me shtresen e fundit te kubezave. Duhet parapare edhe vendosjen e kapakeve prej gize sipas detailit ne projekt.	cope	45.00	70.00	3,150.00
4.1.7	Furnizimi dhe montimi i uleseve ne pjesen e shetitores - parkut . Dimensionet dhe dizajni te punohet sipas detailit te veqant ne projekt. Duhet llogaritur te gjitha punet percjellese te montimit te tyre.	cope	125.00	250.00	31,250.00
4.1.8	Furnizimi dhe montimi i shportave per hudhjen e mbeturinave. Dimensionet dhe dizajni te punohet sipas detailit te veqant ne projekt . Duhet llogaritur te gjitha punet percjellese te montimit te tyre.	cope	40.00	65.00	2,600.00
4.1.9	Furnizimi, transporti dhe vendosja e gureve skajor nga betoni per kufizimin e trotuareve ne pjesen e shetitores me dimensione 10x20cm sipas normave dhe standardeve ne fuqi per kete lloj pune.	m ¹	2,700.00	6.00	16,200.00
4.1.10	Furnizimi, transporti, ngjeshja, nivelizimi i dheut organik si dhe mbjelja e barit ne pjeset e planifikura me gjelbrim me trashesi h=0.25m. Planifikimi parashihet ne dy anet e rruges dhe ne pjesen ku parashihet vendosja e materialit stabilizues.	m ²	465.00	6.00	2,790.00
4.1.11	Furnizimi dhe mbjelja e drunjeve neper trotuare ne distanca 600 5m. Lloji i drunjeve qe duhet te perdoren duhet ti permbahet udhezimeve te projektantit dhe organit mbikqyres dhe ne pershtatje te natyres se rruges e cila ndertohet.	cope	624.00	25.00	15,600.00
Total Pozicioni 4.1 :					169,141.20

Total Pozicioni 4 :

169,141.20



PARAMASA DHE PARALLOGARIA

5.1 Punet e dheut		Pershkrimi i pozicionit			
Pos	Njesia	Sasia	Grimi	Gjithsesi	
5.1.1	m ³	1,510.0	2.00	3,020.00	
Gërmimi i kanalit nga dheu i kat. III - IV me makinë. Me gjersi varësisht nga diametri i gypit dhe thellësia (H _{min} = 1.10 m).					
5.1.2	m ³	685.0	8.00	5,480.00	
Furnizimi, transporti, shtrija dhe planifikimi i reres nën, rreth dhe mbi gypat e ujësjellësit më trashësi d=15cm, fraksion 0-16 mm Ngjeshja të bëhet sipas normave DIN, Dpr 103%					
5.1.3	m ³	1,060.0	8.00	8,480.00	
Furnizimi, transporti, shtrija dhe planifikimi i zhavorrit, fraksion 0-63.0 mm për mbushjen e kanalit nga pjesa e sipërme e gypit deri në nivelin e konstruktonit të rrugës dhe trotuarëve. Ngjeshja të bëhet sipas normave DIN, Dpr 103%					
5.1.4	m ³	1,510.0	2.00	3,020.00	
Ngarkimi dhe transporti i dheut të tepërt deri në depomi të ajtetit ose në vendin ku e cakton organi mbikqyrës në largësi deri në 5km.					
Total Pozicioni 5.1:				20,000.00	

5.2 Punet e dheut		Pershkrimi i pozicionit			
Pos	Njesia	Sasia	Grimi	Gjithsesi	
5.2.1	copë	5	650.00	3,250.00	
Ndërtimi i pusetave sipas planeve egzekutive. Dimensionet dhe gjeometria e pusetave të përshatet me montimin e pjesëve fazonike. Në grim të llogaritet edhe kapaku i metalit me aftësi mbajtëse 40 ton.					
5.2.2	m ³	2.50	85.00	212.50	
Furnizimi dhe vendosja në vepër e betonit për ankerimin horizontal dhe vertikal të gypave sipas detaleve në projekt.					
5.2.3	m ³	1.50	85.00	127.50	
Furnizimi dhe vendosja në vepër e blloqeve të betonit për stabilizimin e pjesëve fazonike në puseta					
5.2.4	copë	25	25.00	625.00	
Punimi dhe montimi i shkallëve metalike prej armaturës Ø 20mm, ngjyroja me minimum dhe një shtresë ngjyrë.					
Total Pozicioni 5.2:				4,215.00	

5.3 Punet e instalues		Pershkrimi i pozicionit			
Pos	Njesia	Sasia	Grimi	Gjithsesi	
5.3.1	m ¹	1660.00	17.85	29,631.00	
Furnizimi, transporti, lidhja dhe instalimi i gypave PE 100, PN 10, Ø225 mm					
5.3.2	m ¹	200.00	108.40	21,680.00	
Furnizimi, transporti, lidhja dhe instalimi i gypave PE 100, PN 10, Ø560 mm					
5.3.3	m ¹	200.00	140.00	28,000.00	
Furnizimi, transporti, lidhja dhe instalimi i gypave PE 100, PN 10, Ø630 mm					
5.3.4	m ¹	2060.00	0.90	1,854.00	
Furnizimi dhe vendosja e shiritit sinjalizues					
5.3.5	m ¹	120.00	150.00	18,000.00	
Furnizimi, transporti dhe montimi i gypave metalik per kalimin e rruges Ø800					
Total Pozicioni 5.3:				99,165.00	

5.4 Punet e montues		Pershkrimi i pozicionit			
Pos	Njesia	Sasia	Grimi	Gjithsesi	
Furnizimi, transporti dhe montimi i pjesëve fazonike nga materiali i PE100, PN 16 bar dhe material të gizes siq vijon:					
5.4.1	copë	2	150.00	300.00	
Muf elektrosaldues Ø160					
5.4.2	copë	5	125.00	625.00	
Muf elektrosaldues Ø160					
5.4.3	copë	8	125.00	1,000.00	
Muf elektrosaldues Ø225					
5.4.4	copë	12	150.00	1,800.00	
AF komplet Ø225/DN200					
5.4.5	copë	8	132.00	1,056.00	
FF DN 200/600					
5.4.6	copë	4	136.00	544.00	
T DN 200/200					
5.4.7	copë	8	155.00	1,240.00	
Kompenzator Dilatimi DN 200					
5.4.8	copë	8	120.00	960.00	
Valvole DN 200					
5.4.9	copë	8	120.00	960.00	
Blind DN 225					
5.4.10	copë	1	250.00	250.00	
Q 45 DN 630					
5.4.11	copë	1	250.00	250.00	
Q 45 DN 560					
Total Pozicioni 5.4:				8,285.00	

5.5 Punet e montues		Pershkrimi i pozicionit			
Pos	Njesia	Sasia	Grimi	Gjithsesi	

5.5.1	Dezinfektimi i gypsjellësit	m'	2060.00	0.40	824.00
5.5.2	Shqyrtimi i gypsjellësit	m'	2060.00	0.40	824.00

Total Pozicioni 5.1:					1,648.00
Total Pozicioni 5:					134,013.00

PARAMASA DHE PARALLOGARIA

Pos	Punët e dheut	Njesia	Sasia	Çmimi	Gjithsej
6.1	Pershkrimi i pozicionit:				
6.1.1	Demolimi i pusëve të kanalizimeve egzistuese, ujvëmbledhëse me ngarkim dhe transport deri në 20km	copw	30	50.00	1,500.00
6.1.2	Demolimi i gypave të kanalizimeve egzistuese me ngarkim dhe transport deri në 20km	m'	700	5.00	3,500.00
6.1.3	Germimi i kanaleve për vendosjen e ujërave të zeza dhe ajrë atmosferik në dy anet e rrugëve. Punimet e germimit dhe hapjes së kanaleve bëhen pas germimit të gjere dhe mbushjeve zhavorike për krijimin e pistes së bazës së rruges. Në çmim duhet llogaritur edhe transportin e materialit deri në deponin e caktuar.	m ³	10175.00	3.00	30,525.00
